



Agjencia Kombëtare e
Kontrollit të Cannabis-it

BULETIN 03



BULETIN

KORRIK - SHTATOR 2026

PËRMBAJTJA

- 01 **AKKC dhe SCFM drejt formalizimit të bashkëpunimit për analizat laboratorike të *cannabis*-it**
- 02 **Miratohet vendimi për shenjimin dhe gjurmueshmërinë e *cannabis*-it**
- 03 **Tarifa për gjurmueshmërinë e *cannabis*-it**
- 04 **Hap i ri për *cannabis*-in: Këshilli i Ministrave miraton Regjistrin Kombëtar**
- 05 **Marrëveshje për forcimin dhe monitorimin e kontrollit të *cannabis*-it**
- 06 **Drejt bashkëpunimit me EU4LEA për forcimin e kapaciteteve institucionale**
- 07 **Regjistri Kombëtar i *Cannabis*-it: Nga vendimi tek zbatimi digjital**
- 08 **Njihuni me stafin e Agjencisë.**

AKKC DHE SCFM DREJT FORMALIZIMIT TË BASHKËPUNIMIT PËR ANALIZAT LABORATORIKE TË CANNABIS-IT

Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis-it* po avancon drejt krijimit të një mekanizmi të qëndrueshëm për analizimin laboratorik të mostrave të *cannabis-it*, si pjesë e forcimit të kapaciteteve të saj mbikëqyrëse.

Në këtë kuadër, më 16 korrik 2026, përfaqësues të Agjencisë zhvilluan një vizitë teknike pranë Stabilimentit Kimiko-Farmaceutik Ushtarak (SCFM) në Firenze. Vizita kishte në fokus vlerësimin e kapaciteteve të këtij institucioni dhe përcaktimin e kuadrit konkret të bashkëpunimit për kryerjen e analizave laboratorike.

Bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve synon të mbulojë të gjithë procesin e analizimit të mostrave, nga dërgimi i tyre deri në lëshimin e Certifikatës së Analizës.

Gjithashtu u prezantua paneli analitik i parashikuar për lulesat e thara të *cannabis-it*, të mbështetur në kërkesat e Farmakopesë Evropiane.

U vizituan ambientet laboratorike, ku përfaqësuesit e Agjencisë u njohën me pajisjet, organizimin analitik dhe sistemin e kontrollit dhe sigurimit të cilësisë të zbatuar nga SCFM-ja sipas kërkesave GMP.



“ Ky bashkëpunim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një sistemi kombëtar të besueshëm, transparent dhe në përputhje me standardet evropiane për kontrollin e *cannabis-it*.

MIRATOHET VENDIMI PËR SHENJIMIN DHE GJURMUESHMËRINË E CANNABIS-IT

Këshilli i Ministrave miratoi më datë 22 korrik 2026 vendimin që plotëson kuadrin nënligjor lidhur me shenjimin dhe gjurmueshmërinë e bimës së *cannabis*-it, të nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të saj për qëllime mjekësore dhe industriale, në zbatim të ligjit nr. 61/2023.



Vendimi 593

"Për përcaktimin e kërkesave për gjurmueshmërinë e bimës së *cannabis*-it, të nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të saj, për qëllime mjekësore dhe industriale, të rregullave për elementet dhe etiketën e shenjimit, të procedurës e të mënyrës së shenjimit e të gjurmimit, si dhe të autoritetit të autorizuar për realizimin e shenjimit e të gjurmueshmërisë."

Përcakton në mënyre të detajuar kërkesat teknike për sistemin e shenjimit dhe të gjurmueshmërisë, elementet e etikës së shenjimit si edhe do të mundësojë ndjekjen e plotë të materialit nga origjina deri në destinacionin përfundimtar.

TARIFA PËR GJURMUESHMËRINË E *CANNABIS*-IT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I MINISTRAVE

Me vendimin e ri të datës 22 korrik 2026 të Këshillit të Ministrave, përcaktohen kategoritë e tarifave që lidhen me përdorimin e sistemit dhe realizimin e procesit të shenjimit dhe gjurmimit.

Vendimi 594

“Për përcaktimin e tarifës dhe procedurat e pagesës së kostos së shenjimit dhe gjurmimit të bimës së *cannabis*-it dhe të nënprodukteve dhe produkteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale.”

Vendimi përcakton rregulla të qarta për faturimin, pagesën dhe aktivizimin e etiketave të shenjimit, duke standardizuar përdorimin e sistemit të gjurmimit si edhe do të mundësojë ndjekjen e plotë të materialit nga origjina deri në destinacionin përfundimtar.

HAP I RI PËR CANNABIS-IN: KËSHILLI I MINISTRAVE MIRATON REGJISTRIN KOMBËTAR

Regjistri do të administrohet nga Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe do të përmbajë informacionin për proceset e licencimit, lejimit dhe autorizimit, si dhe të dhënat për kultivimin, përpunimin, transportin, eksportin, gjurmueshmërinë, kontrollet, inspektimet dhe masat administrative.

Administrimi i Regjistrit

Me qëllim lehtësimin e procedurave të aplikimit dhe verifikimit të të dhënave, Regjistri do të ndërveprojë me sistemin e shënjitimit dhe gjurmueshmërisë, si dhe bazat e të dhënave shtetërore duke përfshirë regjistrin për gjendjen civile, regjistrin tregtar, sistemin tatimor dhe sistemin doganor.

Shkëmbimi i të dhënave

Ky ndërveprim do të mundësojë shkëmbimin dhe sinkronizimin e informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse, duke forcuar bashkërendimin ndërinstitucional dhe duke krijuar kushtet për verifikime më të shpejta, më të sakta dhe të mbështetura në të dhëna të përditësuara.

Siguria dhe konfidencialiteti

Vendimi përcakton gjithashtu nivelet e aksesit të përdoruesve, përgjegjësitë e institucioneve dhe subjekteve të licencuara dhe të lejuara, regjistrimin e veprimeve në log-e të auditueshme, si dhe masat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit.

Monitorimi dhe kontrolli

Krijimi i Regjistrit përbën një hap të rëndësishëm drejt forcimit të kontrollit dhe mbikëqyrjes së aktivitetit të licencuar dhe të lejuar të bimës së *cannabis*-it. Ai synon të rrisë transparencën, gjurmueshmërinë dhe përgjegjshmërinë në çdo fazë të aktivitetit, si dhe të mbështesë përmbushjen e standardeve të larta të sigurisë, kontrollit dhe administrimit të të dhënave.

Nëpërmjet administrimit të integruar të informacionit, Regjistri do të ndihmojë Agjencinë dhe institucionet e përfshira në evidentimin në kohë të problematikave, në monitorimin e veprimtarisë së subjekteve dhe në marrjen e masave të nevojshme administrative.

MARRËVESHJE PËR FORCIMIN DHE MONITORIMIN E KONTROLLIT TË *CANNABIS*-IT

U nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit që synon forcimin e koordinimit ndërinstitutional ndërmjet Agjencisë, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it, znj. Anila Alliu dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, z. Besmir Beja. Marrëveshja synon gjithashtu kontrollin dhe monitorimin e procedurave të importit dhe eksportit të *cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe industriale.



Në zbatim të kësaj marrëveshjeje palët do të bashkëpunojnë për verifikimin e dokumentacionit, shkëmbimin e sigurt të të dhënave, identifikimin dhe parandalimin e shkeljeve, si dhe zhvillimin e kontrolleve dhe veprimtarive të përbashkëta, duke përfshirë mekanizma të përbashkët të menaxhimit të riskut dhe trajnime për forcimin e kapaciteteve institucionale.

Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje përbën një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit të bashkëpunimit ndërinstitutional, duke synuar rritjen e efektivitetit të kontrolleve dhe garantimin e zbatimit të legjislacionit, si dhe krijimin e një sistemi të sigurt, transparent dhe të gjurmueshëm për monitorimin e importit dhe eksportit të *cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe industriale.

DREJT BASHKËPUNIMIT ME EU4LEA PËR FORCIMIN E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE

Në kuadër të njohjes së ndërsjellë institucionale dhe shkëmbimit të informacionit mbi fushat e veprimtarisë së Agjencisë dhe objektivat e projektit EU4LawEnforcement, u vlerësua rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe mundësitë për zhvillimin e iniciativave të përbashkëta në fusha me interes të ndërsjellë, përfshirë ngritjen e kapaciteteve profesionale, shkëmbimin e ekspertizës dhe përafrimit me standardet e Bashkimit Evropian në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së *cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe industriale.



Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, znj. Anila Alliu, zhvilloi një takim institucional me përfaqësuesit e projektit EU4LawEnforcement, të kryesuar nga Koordinatori Ndërkombëtar i projektit, z. Giovanni Pasqua, i shoqëruar nga Eksperti për Prokurorinë, z. Carmine Pirozzoli.

Takimi pati një frymë bashkëpunimi konstruktiv dhe shënoi një hap të rëndësishëm drejt vendosjes së një dialogu të qëndrueshëm institucional, me synim mbështetjen e mëtejshme të forcimit të sundimit të ligjit, rritjes së kapaciteteve institucionale dhe avancimit të standardeve evropiane në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së *cannabis*-it.

REGJISTRI KOMBËTAR I CANNABIS-IT: NGA VENDIMI TEK ZBATIMI DIGJITAL


Përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it u takuan me përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), në kuadër të ngritjes dhe funksionalizimit të Regjistrit, duke përfshirë mbështetjen teknike të AKSHI-t për zhvillimin, hostimin dhe funksionimin e tij.



Regjistri Kombëtar do të shërbejë për administrimin dhe përditësimin e të dhënave mbi aktivitetet e licencuara dhe të lejuara në fushën e *cannabis*-it, duke mbështetur digjitalizimin e proceseve, kontrollin dhe gjurmueshmërinë, si dhe sigurinë dhe administrimin e të dhënave.



Agjencia dhe AKSHI do të vijojnë bashkëpunimin për përcaktimin dhe konkretizimin e kërkesave funksionale dhe teknike të Regjistrit, përfshirë kategoritë e të dhënave që do të administrohen, proceset që do të mbështeten elektronikisht dhe funksionalitetet e nevojshme për operimin e tij.



Bashkëpunimi me AKSHI-n për ngritjen e Regjistrit Kombëtar përbën një hap të rëndësishëm në zhvillimin e infrastrukturës digjitale të Agjencisë dhe në forcimin e mekanizmave për administrimin, kontrollin dhe monitorimin efektiv të veprimtarive të licencuara dhe të lejuara në fushën e *cannabis*-it.

[Lexo më shumë...](#)

NJIHUNI ME STAFIN E AGJENCISË



Eldi Sherifi është jurist dhe Doktor i Shkencave në fushën e së Drejtës Publike, me një përvojë të konsoliduar profesionale prej shumë vitesh në administratën publike, ku ka ushtruar detyra të ndryshme pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Paralelisht, ka më shumë se një dekadë përvojë në mësimdhënien universitare të së drejtës në universitete të ndryshme në Shqipëri. Që prej shtatorit 2024 është pjesë e Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it, ku aktualisht mban detyrën e Koordinatorit për Çështjet Ekzekutive

Eldi Sherifi

“Institucionet ndërtohen çdo ditë, në mënyrën si mendojmë, komunikojmë dhe veprojmë.”



**Agjencia Kombëtare e
Kontrollit të Cannabis-it**



www.nacc.gov.al



info@nacc.gov.al



Rruga "Ibrahim Rugova", 5,
Kati 13, 1001, Tiranë